



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	04.05.2026
Referencë	11-344/4
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-prill

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit prill Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara sipas planifikimeve dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektori i mjedisit-ambientit- Sipas kërkesave dhe ankesave nga qytetarët është inspektuar në fshatin Glllogovc për ndotje të pronës private, tokë bujqësore, si pasojë e mbylljes së gropës septike për ujëra të zeza të rrjetit kryesor, ku edhe është bërë raport për gjendjen në teren dhe i është dërguar drejtorisë DSHPMSh në kompetencë.

Inspektim sipas ankesës në fsh Marevc kundër një subjekti Auto Limar për ndotje të pronës së tjetrit me mbeturina, pastaj njoftime nga qytetarët për ndotje të mjedisit me mbeturina. Të gjitha rastet janë shqyrtuar, janë dhënë urdhëresa për mënjanimin e të metave, si dhe janë shqiptuar gjopa mandatore për ndotje të mjedisit me mbeturina.

Sipas rregullores komunale, për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, janë urdhëruar me aktvendim të gjitha bizneset në qytet të cilët shfrytëzojnë hapësirën publike përpara lokaleve të tyre, që të pajisen me pëlqim nga drejtoria përkatëse e Komunës.

Është bërë inspektim në disa fshatra, a po respektohen oraret e grumbullimit, transportimit të mbeturinave nga qytetarët nga KRM Pastrimi.

Janë inspektuar objektet në ndërtim e sipër në Rr. “Sadik Shala” në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale. Janë shqiptuar gjopa me aktvendim për mos zbatim të kushteve të LMK-së, respektivisht ndotje të mjedisit si pasojë e ndezjes së mbeturinave.

Jemi takuar dhe kemi biseduar me zyrtaren për mjedis në kuadër të Aeroportit në lidhje me prezencën e mbeturinave të hedhur nga qytetarët dhe mundësinë e pastrimit të tyre tek parkingu i vjetër i Aeroportit. Edhe pse ajo pjesë nuk është në kompetencë të menaxhohet nga Aeroporti, pastrimi i hapësirës nga mbeturinat është bërë nga një kompani të kontraktuar nga Aeroporti.

Janë inspektuar disa deponi ilegale të mbeturinave për të marrë masa ligjore ndaj atyre që takohen apo gjeten dëshmi për ndotjen e mjedisit.

Inspektorët e trafikut- Gjatë muajit prill nga inspektorët e trafikut janë zhvilluar aktivitetet të vazhdueshme inspektues.

Janë realizuar kontrollat ndaj operatorëve të transportit me autobus për rendet e udhëtimit, ku janë verifikuar pikat e ndalimit si dhe funksionimi i operatorëve që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Komunës së Lipjanit.

Gjithashtu, janë zhvilluar inspektime të rregullta ndaj auto-taksive dhe radio-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari”, në fokus të veçantë në identifikimin dhe parandalimin e veprimtarive ilegale, si dhe të operatorëve që ofrojnë shërbime pa porosi paraprake.

Në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit në fuqi, janë realizu inspektime në rrugët e qytetit për verifikimin nëse auto-taksit janë të pajisur me licenc valide për ushtrimin e veprimtarisë, të lëshuar nga organet kompetente.

Po ashtu, bazuar në ankesat-kërkesat e ndryshme të pranuar nga qytetarët në sektorë, janë zhvilluar inspektime në disa fshatra të komunës.

Në vazhdimësi, gjatë ditëve të hëna, janë zhvilluar kontrole në tregjet e qytetit, përfshirë tregun e kafshëve, mobileve dhe të gjelbërt.

Inspektori i ndërtimit- Përgjatë muajit prill inspektori i ndërtimitarisë ka inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi në teren, e sidomos përgjatë zonës urbanistike, industriale, ekonomike. Me procesverbal është evidentua dhe konstatuar për të gjitha ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi. Ndaj ndërtimeve pa leje janë realizu hapat procedural ligjor.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjegjur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit prill janë:

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Vendosje të shiritave zyrtar.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Objekte të legalizuara	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Njoftime	Vërejtje	Pranim teknik me komision (projekte komunale)	Vendosje të shiritave	Inspektime me miratim	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoba mandatore	Njoftim për fillimin e ndërtimeve	Leje ndërtimore	Menaxhim i tregjeve	Aktvendime, ndalesa, urdhëresa	Inspektime për leje Mjedisore Komunale	Inspektim me polici	Inspektime të përbashkëta
Ambienti	67	7								8	6				5				37	4		
Ndërtimi	58	17	4			4			3			23			3		3		1			
Trafiku	93	15					18			21	16	1						7			5	10
Gjithsej	218	39	4			4	18		3	21	24	30			8		3	7	38	4	5	10

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet kryesisht janë mbajtur me qytetarë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.